

VENDIM
Nr. 581, datë 18.9.2024

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 130, DATË 6.3.2024, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË TË SEKTORËVE QË
DO TË MBËSHTETEN DHE TË MASËS SË FINANCIMIT NGA FONDI I
PROGRAMIT PËR BUJQËSINË E ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2024”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”; të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 130, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2024”, bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:

“d) rritjen e kapaciteteve të prodhimit në ferma, nëpërmjet mbështetjes së investimeve për ndërtimin e serrave dhe stallave, për rrjeta antibreshër, mekanikë bujqësore dhe akuakulturë.”.

2. Pas pikës 2.2 shtohet pika 2.3, me këtë përmbajtje:

“2.3 Mbështetje për investime në ferma:

a) Për ndërtimin e serrave diellore të reja, me sipërfaqe jo më pak se 0.2 (zero pikë dy) ha dhe jo më shumë se 2 (dy) ha për subjekt, përfshirë edhe instalimin e sistemit të ujitjes.

Masa e përfitimit të jetë 50% e vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se:

- 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë/ha për serrat e prodhimit të perimeve;

- 8 000 000 (tetë milionë) lekë/ha për serrat e prodhimit të rrushit për tavolinë;

- 4 000 000 (katër milionë) lekë/ha për serrat (tunelet plastike) të prodhimit të luleshtrydheve;

b) Rrjeta për mbrojtjen e prodhimit nga breshëri në blloqet ekzistuese me pemë frutore, agrume dhe vreshta. Masa e përfitimit të jetë 50% e vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë/ha. Në këtë rast, financimi bëhet për sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha dhe jo më shumë se 5 (pesë) ha;

c) Për ndërtimin e ambienteve për mbarështimin e kafshëve dhe stabilimenteve për rritjen e shpendëve, me kapacitet jo më pak se 10 (dhjetë) lopë, jo më pak se 100 (njëqind) të imëta, jo më pak se 10 (dhjetë) dosa dhe jo më pak se 10 000 (dhjetë mijë) shpendë.

Masa e përfitimit të jetë 50% e vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë për subjekt;

ç) Për blerjen e traktorëve, makinerive dhe pajisjeve për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në fermat bujqësore dhe blegtorale.

Masa e përfitimit të jetë 50% e vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë për subjekt;

d) Mbështetje për akuakulturën detare për koshat e rritjes së peshkut (vetëm për koshat dhe rrjetat). Masa e përfitimit të jetë 50% e vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 20 000 000 (njëzet milionë) lekë për subjekt.”.

3. Pas pikës 3 shtohen pikat 3/1 dhe 3/2, me këtë përmbajtje:

“3/1. Përfituesve të financimit nga masat e mbështetjes së investimeve në pikën 2.3, të këtij vendimi, pas lidhjes së kontratës u paguhet paraprakisht deri në 30% të masës së financimit të kontraktuar, kundrejt garancisë së lëshuar nga shoqëria e sigurimit dhe/ose banka”.

“3/2. Fondi total për pikën 2.3, të këtij vendimi, të jetë në vlerën 1 500 000 000 (një miliard e pesëqind milionë) lekë dhe të përdoret për vitin 2024 deri në 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë,

të akorduar në programin buxhetor 04250, “Zhvillimi rural duke mbështetur prodhimin bujqësor, blegtoral, agroindustrinë dhe marketingun” në shpenzime korrente, duke vijuar plotësimin e vlerës së plotë në buxhetin e vitit 2025, si pjesë e PBA-së 2025–2027.”.

Diferencat eventuale të papërdorura nga fondi prej 500 000 000 (pesëqind milionë) lekësh, për vitin 2024, mund të alokohen për masat mbështetëse, të përcaktuara në pikat 2.1 dhe 2.2, të këtij vendimi.

II. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama